

### Fillon funksionimin Platforma Online për ankesat e qytetarëve

#### Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për vitin 2018
- Zhvillimet e Tregut të Fondeve të Investimeve për vitin 2018

#### Zhvillime të tjera

- 2019, AMF do të organizojë praktikat mësimore të mbi 300 studentëve
- Programi vjetor i aktiviteteve të formimit profesional për vitin 2019
- Takim mbi procesin screening “Kapitulli 4 – Lëvizja e lirë e kapitalit”
- Konferencë mbi balancimin e mundësive dhe risqeve të Fintech në zbatim të Axfordës Bali Fintech (BFA)
- “Standard and Poor’s” vlerëson Shqipërinë me B+

#### Edukimi i Konsumatorit

- Tejkalimi i limiteve në siguroeshmëri (*pjesa e dytë*)


#### Botime Profesionale

#### Lajme Ndërkombëtare

- Greqi
- Kosovë
- Kroaci
- Mali i Zi
- Poloni

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

## Fillon funksionimin Platforma Online për ankesat e qytetarëve



Platforma online e ankesave të qytetarëve krijon mundësinë për çdo konsumator dhe individ të depozitojë problematikën e tij për veprime dhe detyrime që lindin nga aktiviteti i operatorëve ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në tregjet financiare jobankare, nën mbikëqyrjen e AMF-së.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, duke nisur nga data 18 shkurt 2019, ka filluar zbatimin e një regjistri të ri, si një platformë për depozitimin e ankesave të konsumatorëve. Platforma *online* e ankesave të qytetarëve krijon mundësinë për çdo konsumator dhe individ të depozitojë problematikën e tij për veprime dhe detyrime që lindin nga aktiviteti i operatorëve ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në tregjet financiare jobankare, nën mbikëqyrjen e AMF-së.

Kjo Platformë është një mundësi e re për qytetarët, jo vetëm për të paraqitur shqetësimet e tyre, por edhe për të ndjekur më tej ecurinë hap pas hapi të problematikës së paraqitur, për të arritur deri në zgjidhjen përfundimtare të saj.

Fillimi i kësaj Platforme të re është një mundësi më shumë që u ofrohet qytetarëve për të trajtuar dhe zgjidhur problemet e tyre, duke realizuar kështu një nga misionet kryesore të punës së Autoritetit. AMF është e angazhuar dhe ka prioritet të punës së saj, mbrojtjen dhe edukimin e konsumatorit dhe investitorit.

Në linkun e mëposhtëm gjeni hapat që duhet të ndiqni për depozitimin e një ankesë dhe ndjekjen e saj në faqen zyrtare të AMF-së.

[Depozitimi i Ankesave Online](#)

# VËSHTRIM MBI TREGJET

## Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për vitin 2018


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për vitin 2018 kapën vlerën mbi 16,921 milionë lekë, ose 4.49% më shumë se në vitin 2017. Gjatë vitit 2018, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 1,309,143 me një rritje prej 5.89% krahasuar me vitin 2017.

Tregu vazhdoi të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 92.93% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, duke i lënë përkatësisht sigurimet e Jetës me 6.75% dhe veprimtarinë e risigurimit me 0.32%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 36.59% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 63.41% të totalit të tregut.

Gjatë vitit 2018, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 6,972 milionë lekë, ose 26.23% më shumë se në vitin 2017.

Gjatë vitit 2018, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 6,972 milionë lekë, ose 26.23% më shumë se në vitin 2017.


### Struktura e tregut të sigurimeve, viti 2018



## Zhvillimet e Tregut të Fondeve të Investimeve për vitin 2018

Gjatë vitit 2018, në tregun e fondeve të investimeve ushtruan aktivitetin e tyre pesë fonde investimi. Fondi i investimeve “Raiffeisen Prestigj”, fondi i investimeve “Raiffeisen Invest Euro”, fondi i investimeve “Raiffeisen Vizion” të cilat administrohen nga shoqëria “Raiffeisen Invest”, fondi i investimeve “Credins Premium” nën administrimin e shoqërisë administruese “Credins Invest” dhe fondi “WVP Top Invest” e cila administrohet nga shoqëria “WVP Fund Management Tirana sh.a”.

Ndarja e tregut sipas vlerës së aseteve neto të Fondeve të Investimit, viti 2018



Numri i anëtarëve që kanë investuar në Fondet e Investimit më 31.12.2018 është 29,420 me një ulje prej 6.07% krahasuar me 31.12.2017.

Sipas analizës së të dhënave për tregun e fondeve të investimeve në 31.12.2018, vlera neto e aseteve të Fondeve, arriti rreth 66.09 miliardë lekë me një ulje prej 6.63 miliardë lekë ose 9.12%, krahasuar me 31.12.2017. E shprehur në euro, totali i aseteve neto është 535 milionë Euro.

Ky treg dominohet kryesisht nga investimet në Obligacione Qeveritare, të cilat përbëjnë 61.25% të aseteve të fondeve, me një ulje prej 6.65% krahasuar me 31.12.2017. Numri i anëtarëve që kanë investuar në Fondet e Investimit më 31.12.2018 është 29,420 me një ulje prej 6.07% krahasuar me 31.12.2017.

### Tregues të fondeve të investimeve

<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera (mln. lekë)</b>		<b>Ndryshimi (Në %)</b>
	<b>31.12.'17</b>	<b>31.12.'18</b>	<b>31.12.'17-31.12'18</b>
Asetet neto të FI	72,717	66,087	(9.12)

# ZHVILLIME TË TJERA

## 2019, AMF do të organizojë praktikat mësimore të mbi 300 studentëve

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka vendosur të përfshihet për herë të parë në procesin e organizimit dhe koordinimit të praktikave mësimore të studentëve pranë shoqërive që veprojnë në tregjet nën mbikëqyrjen e tij.

Autoriteti i ka kërkuar kompanive që veprojnë në tregun e sigurimeve, fondeve të investimeve dhe pensioneve private vullnetare që të angazhohen për të mirëpritur për zhvillimin e praktikave mësimore një numër prej të paktën 300 studentësh.

Të rinjtë janë pjesë e universiteteve, publike ose private, me të cilët AMF ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi. Ata do të kenë mundësi të njihen me shoqëritë, tregun ku ushtrojnë veprimtarinë, si edhe alternativat potenciale që mund t'u ofrohen në tregun e punës në Shqipëri në këtë sektor, pas përfundimit të studimeve të larta universitare.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka vendosur të përfshihet për herë të parë në procesin e organizimit dhe koordinimit të praktikave mësimore të studentëve pranë shoqërive që veprojnë në tregjet nën mbikëqyrjen e tij.



Gjatë një aktiviteti për edukimin financiar me studentë

Subjektet nën mbikëqyrje i janë përgjigjur pozitivisht dhe e kanë vlerësuar iniciativën e Autoritetit dhe AMF është aktualisht e angazhuar në procesin e koordinimit mes universiteteve dhe shoqërive për caktimin e periudhës së përshtatshme për zhvillimin e praktikës mësimore.

Mbi 90 studentëve do të zhvillojnë praktika mësimore në sistemin bankar, për t'u njohur nga afër me funksionin e bankave të nivelit të dytë si broker, kujdestar apo shoqëri komisionere. 55 studentë do t'i zhvillojnë praktikat mësimore pranë shoqërive të tregut të sigurimeve, rreth 130 në shoqëritë që operojnë në tregun e investimeve dhe mbi 20 studentë do të njihen nga afër me shoqëritë e fondeve të pensioneve private vullnetare.

Kjo iniciativë do të vijojë të jetë kontributi që AMF në bashkëpunim me subjektet nën mbikëqyrje jep për edukimin financiar të brezit të ri, pasi kjo nismë do të shërbejë për të rritur edukimin financiar të studentëve, do t'u japë atyre më shumë informacion në lidhje me tregjet financiare jobankare dhe do t'i stimulojë të bëhen pjesë e tyre me daljen në tregun e punës.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare e vlerëson si shumë të rëndësishëm bashkëpunimin me institucionet publike, subjektet nën mbikëqyrje dhe grupet e ndryshme të interesit për të rritur shkallën e edukimit financiar, në funksion të mbrojtjes së konsumatorit dhe zhvillimit të sigurt të tregjeve nën mbikëqyrje. Gjithashtu, ashtu si çdo vit Autoriteti do të presë studentët e interesuar për zhvillimin e praktikave të tyre mësimore pranë AMF-së.

Kjo iniciativë e AMF-së është në vazhdim të punës së bërë gjatë vitit 2018, kur Autoriteti nënshkroi 8 marrëveshje bashkëpunimi me universitete dhe kolegje universitare të ndryshme private dhe publike, duke u dhënë kështu studentëve të tyre mundësinë për t'u njohur me aktivitetin e AMF-së dhe tregjeve nën mbikëqyrje. Gjithashtu, u organizua konferenca e parë kombëtare për "Edukimin Financiar", ku studentët u përfshinë aktivisht me punimet e tyre në lidhje me tregjet nën mbikëqyrje.

Koordinimi i praktikave mësimore të studentëve është pjesë e "Strategjisë për rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit në tregjet financiare nën mbikëqyrje". Ai është një kontribut direkt që jep Autoriteti jo vetëm në funksion të rritjes së njohurive financiare në aspektin teorik, si edhe praktik për studentët, por edhe për shoqëritë që operojnë në tregjet nën mbikëqyrje për evidentimin e profesionistëve të së ardhmes.



—○○○—  
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare organizon trajnime për “Kualifikim profesional bazë” për të gjithë individët, të cilët dëshirojnë të licencohen për herë të parë në një nga profesionet e tregjeve nën mbikëqyrje, si dhe trajnime për “Kualifikim profesional në vazhdimësi” për drejtuesit dhe profesionistët që operojnë në këto tregje.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare organizon trajnime për “Kualifikim profesional bazë” për të gjithë individët, të cilët dëshirojnë të licencohen për herë të parë në një nga profesionet e tregjeve nën mbikëqyrje, si dhe trajnime për “Kualifikim profesional në vazhdimësi” për drejtuesit dhe profesionistët që operojnë në këto tregje, duke kontribuar kështu në rritjen e kapaciteteve profesionale të tyre dhe përditësimin e njohurive mbi tregjet nën mbikëqyrje bazuar edhe në praktikat më të mira ndërkombëtare.

Gjatë vitit 2019 Autoriteti do të organizojë aktivitetet e formimit profesional si më poshtë:

### **Mars**

“Kualifikim profesional bazë” për broker në sigurime.

### **Prill**

“Kualifikimi profesional në vazhdimësi” për vlerësues dëmsh në sigurime.

### **Maj**

“Kualifikim profesional bazë” për vlerësues dëmsh në sigurime.

### **Qershor**

“Kualifikim profesional bazë” për:

- Vlerësues dëmsh në sigurime;
- Profesionistët në tregun e titujve.

### **Qershor/Korrik**

“Kualifikimi profesional në vazhdimësi” për aktuar.

### **Shtator**

“Kualifikimi profesional në vazhdimësi” për broker në sigurime.

### **Tetor/Nëntor**

“Kualifikimi profesional në vazhdimësi” për profesionistët në tregun e titujve.

## Takim mbi procesin screening “Kapitulli 4 – Lëvizja e lirë e kapitalit”

Në datën 11 Janar 2019, në Bruksel u zhvillua takimi shpjegues lidhur me procesin e screening, për Kapitullin 4 lidhur me lëvizjen e lirë të kapitalit në vendet e Bashkimit Evropian, si një ndër parimet kryesore të lëvizjes së lirë të kapitalit, i cili duhet të integrohet në legjislacionin e vendeve që aspirojnë për t’u bërë anëtarë të BE-së.

Në këtë takim morën përfaqësues të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Bankës së Shqipërisë, si dhe Drejtorisë së Parandalimit të Pastrimit të Parave.

## Konferencë mbi balancimin e mundësive dhe risqeve të Fintech në zbatim të Axhendës Bali Fintech (BFA)

Banka Qendrore e Austrisë në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të Austrisë, Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Joint Vienna Institute, zhvilluan në datat 28-29 janar, konferencën mbi zhvillimet e reja të teknologjive në sektorin financiar dhe diskutimet mbi Programin e Fintech në zbatim të Axhendës Bali Fintech (BFA).



Gjatë zhvillimit të konferencës

Banka Qendrore e Austrisë në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të Austrisë, Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Joint Vienna Institute, zhvilluan në datat 28-29 janar, konferencën mbi zhvillimet e reja të teknologjive në sektorin financiar dhe diskutimet mbi Programin e Fintech në zbatim të Axhendës Bali Fintech (BFA).

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare u përfaqësua në këtë konferencë nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe drejtues të lartë të AMF-së.



Përfaqësues të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore diskutuan mbi një sërë parimesh, mbi politikat udhëzuese mbi teknologjitë financiare, të njohura sot në botën financiare me termin Fintech. Gjatë konferencës, përfaqësues të vendeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore, si dhe vendeve të Azisë Qendrore diskutuan e shkëmbyen eksperiencën të vendeve të tyre në lidhje me sfidat që dalin nga Fintech.

Kjo axhendë u prezantua në mbledhjet e vjeshtës të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore, në Bali, në tetor 2018, për të promovuar inovacionin teknologjik në sektorin e shërbimeve financiare. Konferenca ishte e konceptuar në formën e sesioneve, të ndara me tema të ndryshme.

### **“Standard and Poor’s” vlerëson Shqipërinë me B+**



—○○○—  
Agjencia Standard and Poor's ka konfirmuar vlerësimin B+ dhe perspektivën pozitive në vijim për Shqipërinë.  
—○○○—

Agjencia Standard and Poor's ka konfirmuar vlerësimin B+ dhe perspektivën pozitive në vijim për Shqipërinë. S&P parashikon që ekonomia shqiptare të rritet me mesatarisht 4% deri në vitin 2022. Agjencia konstaton përkushtimin e vazhdueshëm në drejtim të konsolidimit fiskal, shoqëruar me një ulje të borxhit publik.

Në bazë të vlerësimeve parashikohet një rritje e qëndrueshme e të ardhurave, mbështetur nga performanca e mirë ekonomike dhe mirëadministrimi.

## Tejkalimi i limiteve në sigurueshmëri

Z. François Villeroy de Galhau, Kryetar i Autoritetit të Mbikëqyrjes së Kujdesshme dhe Rezolutave, si edhe Guvernator i Bankës së Francës në fjalën e tij përshëndetëse në Konferencën 10-të Ndërkombëtare për sigurimet adreson tri çështje të rëndësishme:

- (i) Siguruesit luajnë një rol esencial në financimin e ekonomisë;
- (ii) Ndërhyrje në kuadrin rregullator;
- (iii) Adresimi i emergjencave në lidhje me rreziqet të reja .

Konferenca ndërkombëtare u organizua në Paris në 26 tetor 2018.

(Pjesa e dytë, me shkurtime dhe redaktime)

Në Evropë, rishikimi që do t'i bëhet parimit të *Solvency II* duhet të përfshijë një vlerësim të plotë dhe transparent të kuadrin rregullues që ka ekzistuar për tre vjet. Natyrisht, siguruesit kanë përmirësuar ndjeshëm rrezikun dhe menaxhimin e kapitalit sipas *Solvency II* dhe tregu i sigurimeve tani është më rezistent dhe i pajisur më mirë për të përballuar krizat financiare.

Por këto arritje pozitive nuk duhet të lejohen të zvogëlojnë pikëpyetjet që duhen shtruar pas një ndryshimi kaq të madh, veçanërisht në lidhje me ndikimin mbi investimin e kapitalit dhe financimin e ekonomisë evropiane, së bashku me çështjet që lidhen me paqëndrueshmërinë dhe kompleksitetin.

Pikërisht, fakti që ne po e quajmë atë një "rishikim" për vitin 2020 do të thotë që ruajtja e status quo-së nuk mund të jetë një opsion. Ndërsa puna përgatitore është në progres, do të doja të shihja çdo temë, edhe ato më të vështirat dhe të çuditshmet, të diskutohen dhe të trajtohen.

Unë i bëj thirrje siguruesve të luajnë një rol aktiv në konsultime. Në këtë kuadër, ne mbështesim përpjekjet e bëra nga Thesari i Shtetit francez dhe siguruesit për të përmirësuar trajtimin e kujdesshëm të investimeve afatgjata të kapitalit që po bëhet gjatë rishikimit në vitin 2018.

Do të shtoja se është e rëndësishme që mbikëqyrësit të zbatojnë të gjitha kërkesat e mbikëqyrjes së kujdesshme me të njëjtin rigorozitet. Seria e dështimeve nga siguruesit që kryejnë një aktivitet tregtar në tregun francez nën FPS-në, veçanërisht për sigurimin në fushën e ndërtimit, është një sinjal për të sjellë në vëmendje rëndësinë që ka kjo mbikëqyrje e kujdesshme.

ACPR po punon shumë për t'u marrë me këtë krizë, e cila po prek dhjetëra mijëra policëmbajtës francezë. Por duhet të bëhet edhe konvergjenca e nevojshme e praktikave mbikëqyrëse, për të cilën jam në dijeni se Gabriel Bernardino dhe EIOPA e kanë si prioritet të tyre.

Siguruesit kanë përmirësuar ndjeshëm rrezikun dhe menaxhimin e kapitalit sipas *Solvency II* dhe tregu i sigurimeve tani është më rezistent dhe i pajisur më mirë për të përballuar krizat financiare.

Le t'i kthehemi rreziqeve të reja të cilat po shfaqen si sfida në sektorin e sigurimeve. Do të doja të veçoja tre prej tyre, duke i renditur sipas diapazonit kohor të zbatimit më shumë se pasardhësi: Brexit, siguria kibernetike dhe rreziku i ndryshimeve klimatike.

Së fundmi, dua të qartësoj se, duke marrë parasysh diskutimet aktuale, nuk ka arsye që të zbatohet tani parimi i IFRS 17 (Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar 17). Përveç kompleksitetit të krijimit të një kuadri të qeverisjes evropiane për këto standarde, ekziston edhe një çështje lidhur me kohën, dhe fatmirësisht Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASB) po rihap diskutimet mbi këtë çështje.

Zbatimi i IFRS 17, i cili do të jetë i kushtueshëm dhe kompleks, do të jetë rrjedhojë e zbatimit të *Solvency II*, një proces që i ka mbajtur siguruesit shumë të impenjuar. Përtej çështjes së afateve kohore dhe kalendarit të zbatimit, ka çështje të rëndësishme thelbësore. Ne duam një marrëveshje për identifikimin e grupeve me kontrata të cilat kryejnë shumë dëme.

Siç është tani, drafti është i papërshtatshëm. Ne gjithashtu duam të shohim përfundimin e diskutimeve mbi trajtimin e kontratave të risigurimit. Në këto kushte, ka shumë hapësirë për interpretimin e këtij standardi, që mund të ndërhyjë në krahasueshmërinë dhe konsistencën e zbatimit në të gjitha vendet.

### III. Lindja e rreziqeve të reja

Le t'i kthehemi rreziqeve të reja të cilat po shfaqen si sfida në sektorin e sigurimeve. Do të doja të veçoja tre prej tyre, duke i renditur sipas diapazonit kohor të zbatimit më shumë se pasardhësi: Brexit, siguria kibernetike dhe rreziku i ndryshimeve klimatike.

Në një të ardhme të afërt, fatkeqësisht, Brexit do jetë çështja që do të na mbajë më të impenjuar. ACPR po punon në mënyrë aktive për të siguruar një tranzicion të lehtë, por ka ardhur koha që siguruesit të venë në lëvizje planet e tyre të emergjencës. Kjo do të thotë, të diskutosh me autoritetet mbikëqyrëse në Mbretërinë e Bashkuar dhe në Evropë.

Kjo nënkupton edhe arritjen e marrjen e autorizimeve të reja, transferimin e portofolave, zhvendosjen e kompanive evropiane dhe ngritjen e degëve në vendet e treta. Megjithëse shpresojmë ta shmangim atë, duhet të jemi të gatshëm për një skenar pa-marrëveshje.

Në këtë kuadër, do të preferohej të kishim një legjislacion evropian për të siguruar që çdo çështje e rëndësishme të trajtohet në mënyrë të harmonizuar; megjithatë, nëse do jetë e nevojshme, dhe si mundësi e dytë, legjislacioni i paraqitur në Këshillin e Ministrave më 3 tetor do të na lejojë të ndërmarrim hapa ligjorë në Francë, për të menaxhuar, situata ku kompanitë e Mbretërisë së Bashkuar nuk kanë transferuar ende portofolat e kontratave të tyre për individët e siguruar në Francë.

Industria e sigurimeve me siguri do të marrë këshilla të vlefshme dhe përdorë eksperiencën tuaj në lidhje me rrezikun kibernetik, për të krijuar ofertën tuaj për sigurimin ndaj rrezikut kibernetik.

Do të doja të përmendja se puna e përbashkët e Bankës Qendrore Evropiane dhe Bankës së Anglisë për të vlerësuar rreziqet financiare, u drejtuan në mënyrë specifike tek kontratat e sigurimit, dhe ne besojmë se rreziqet në këtë fushë do të jenë të menaxhueshme, me kusht që ne të garantojmë mbrojtjen e policëmbajtësve.

Në periudhën afatmesme, siguria kibernetike është një shqetësim në rritje për të gjithë bizneset. Siguruesit janë ndër më të prekurit, pasi ata kanë të dhëna sensitive. Industria e sigurimeve me siguri do të marrë këshilla të vlefshme dhe përdorë eksperiencën tuaj në lidhje me rrezikun kibernetik, për të krijuar ofertën tuaj për sigurimin ndaj rrezikut kibernetik.

Së fundmi, rreziku i ndryshimeve klimatike zë afatin më të gjatë kohor nga të tjerët, por megjithatë kërkon veprime konkrete të menjëhershme. Siç tregojnë edhe diskutimet e sotme, regjimi i sigurimeve nga fatkeqësitë natyrore kërkon një rishikim dhe jam i vetëdijsëm se jemi afër reformave në vitin 2019. Por kjo është një fushë shumë e rëndësishme e hetimit për mbikëqyrësit, sepse stabiliteti i klimës në një afat të gjatë kohor është një faktor përcaktues në stabilitetin financiar.

Në qershor të këtij viti, ACPR publikoi një studim ku rreth 10-20% e të gjitha letrave me vlerë, të zotëruara nga siguruesit francezë, janë të ekspozuara ndaj rrezikut në raport me kalimin në një ekonomi me energji të rinovueshme. Në dhjetorin e kaluar, në Paris, Banque de France dhe ACPR kanë ngritur dhe po koordinojnë në mënyrë aktive Rrjetin e Bankave Qendrore dhe Mbikëqyrësve për Gjelbërimin e Sistemit Financiar (*Network for Greening of Financial System NGFS*).

NGFS filloi me tetë mbikëqyrës, ndërsa tashmë numri i anëtarë është 19 dhe pesë vëzhgues, duke përfshirë këtu Forumin e Sigurimit të Qëndrueshëm (SIF). Ne po punojmë fort në dy subjekte, ku siguruesit janë në vend të parë: zbulimi i rreziqeve aktuale të klimës dhe projektimi i provave të rezistencës dinamike me fokus rreziqet e ardhshme. Më 17 prill të vitit të ardhshëm do të prezantohet në një konferencë në Paris, një raport që jep detaje dhe rekomandime rreth vitit të parë të punës.

Unë e kam quajtur financën e gjelbër si "Kufiri i Ri për Shekullin 21". Sot, po diskutojmë për "tejkalimin e limiteve të aftësisë siguroese". Kjo dëshmon rolin tuaj parësor dhe nxit frymën tuaj të sipërmarrjes dhe inovacionit. Rreziqet me të cilat po përballlet bota në vitin 2018 janë pa dyshim në rritje, prandaj ne na nevojiten këto cilësi sot më shumë se kurrë.

# **BOTIME PROFESIONALE**

## **JOURNAL OF RISK MANAGEMENT IN FINANCIAL INSTITUTIONS**

Volumi 11 përmban këto shkrime kryesore:

- Çështje strategjike, ligjore dhe rregullatore në pejsazhin kibernetik (*Strategic, legal, quantitative and regulatory issues in the cyber landscape*)
- Praktikat më të mira të menaxhimit të riskut dhe likuiditetit (*Buy-side liquidity risk management best practices*)
- Testi i fizibilitetit të përlogaritjes së rrezikut të ndërmarrjeve (*A test of the feasibility of a common risk accounting metric for enterprise risks*)

## **JOURNAL OF PENSION ECONOMICS & FINANCE**



Volumi 17 përmban këto shkrime kryesore:

- Reforma e pensioneve publike dhe luhatja e kontributeve (*Contribution volatility and public pension reform*)
- Efekti i taksimit në tërheqjet nga kursimet para pensionit: shembuj nga Kanada (*The effect of tax withholding on pre-retirement savings withdrawals: evidence from Canada*)

## **GLOBAL RISK REGULATOR**

Volumi 17, janar 2019 përmban këto shkrime kryesore:

- Brexit mund të ndikojë marrëveshjet rregullatore ndërkufitare (*Brexit could set tone for cross-border regulatory arrangements*)
- BE forcon mbikëqyrjen për firmat e investimeve (*EU to toughen oversight of investment firms*)
- Evropa e detyruar të rishikojë regjimin e sjelljes pas skandalit të Danske Bank (*Europe forced to rethink conduct regimes following Danske Bank scandal*)
- A janë rregullatorët *onsite* mënyra më e mirë për të sjellë ndryshimin e sjelljes brenda bankave? (*Are onsite regulators the best way to drive behavioural change within banks?*)



# **Global Risk Regulator**

A SERVICE FROM THE BANKER

## Greqi

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Tregu i sigurimeve në Greqi e mbylli vitin 2018 me 3.19 miliardë euro prime të shkruara bruto, me një rritje prej 1.8% krahasuar me një vit më parë. Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës ishin 1.86 miliardë, me një rritje prej vetëm 0.5%. Ndërsa primet e shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës ishin 2.05 miliardë, me një rritje prej 4%.

Shoqata e Siguruesve në Greqi shprehet optimiste për zhvillimin e tregut grek të sigurimeve, i cili rezultoi të jetë i mirëkapitalizuar dhe ka ndërmarrë reforma serioze për qeverisjen e korporatave dhe transparencës. Tregu grek i sigurimeve mbikëqyret nga Banka e Greqisë dhe nga një kuadër institucional gjithëevropian, që është *Solvency II*.

## Kosovë

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës, tregu i sigurimeve në Kosovë e mbylli vitin 2018 me 93.5 milionë euro prime të shkruara bruto, me një rritje prej 7%. Sigurimi i Jo-Jetës realizoi 90.5 milionë prime të shkruara bruto, me një rritje prej 6.5%, nga të cilat 48.6 milionë euro erdhën nga sigurimet MTPL. Në të njëjtën kohë, sigurimi i Jetës realizoi 3 milionë euro prime të shkruara bruto, me 20% rritje.

Përgjatë vitit 2018, në tregun e sigurimeve në Kosovë operuan 14 shoqëri sigurimesh, një më pak se një vit më parë.

## Kroaci

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Primet e shkruara bruto në tregun e sigurimeve për vitin 2018 në Kroaci ishin 9.9 miliardë HRK (kuna kroate, monedha vendase) ose 1.3 miliardë euro, me një rritje prej 8.8% krahasuar me një vit më parë. Kjo rritje erdhi kryesisht nga sigurimi motorik dhe sigurimi i Jetës.

Për vitin 2018, primet e shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës ishin 6.7 miliardë kuna. Në sigurimin e Jetës, primet e shkruara bruto arritën në 3.1 miliardë kuna.

## Mali i Zi

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Në vitin 2018, tregu i sigurimeve në Malin e Zi realizoi 86.83 milionë euro prime të shkruara bruto, me një rritje prej 6.19% krahasuar me një vit më parë. Primet e shkruara bruto për sigurimin e Jo-Jetës ishin 71.6 milionë euro, me një rritje prej 5.91%. Referuar të dhënave të publikuara në faqen e Agjencisë për Mbikëqyrjen e Sigurimeve në Malin e Zi, primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës arritën në 15.23 milionë euro, me 7.51% rritje. Dëmet e paguara bruto nga siguruesit për vitin 2018 janë 42.07 milionë euro, krahasuar me 35.7 milionë që ishin një vit më parë.

## Poloni

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Fondi i Garancisë së Sigurimeve në Poloni, duke përdorur teknologjinë e avancuar, ka prezantuar një platformë të re. Kjo platformë i shërben tregut për zbulimin dhe parandalimin e rasteve të mashtrimit. Sipas vlerësimeve të "Insurance Europe", rreth 10% e pretendimeve për kompensim në Evropë mund të jenë subjekt i parregullsive, të zbuluara apo të pazbuluara.

Anëtarët e Fondit të Garancisë, që janë të gjithë siguruesit që lëshojnë sigurime motorike në Poloni, do të kenë mundësi ta përdorin falas platformën. Fondi i Garancisë, me anë të teknikave të avancuara analitike do të verifikojë me zgjedhje kërkesa për pagesa që mund të ngjallin dyshime. Gjithashtu platforma do të shërbejë për të filtruar rrjetet kriminale që mund të vënë në shënjestër kompanitë e sigurimeve.

## Konferenca për sigurimin motorik në Vjenë

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Në datën 8 prill 2019 në Vjenë, Austri, do të zhvillohet Forumi Ndërkombëtar i Sigurimeve. Disa nga çështjet që pritet të trajtohet në këtë forum janë shfrytëzimi i teknologjisë në ndihmë të siguruesve. Kjo ndihmon për çmime të drejta, lehtësi në shërbim, apo trajtimin eficient të dëmshpërblimeve. Por në anën tjetër, përparimi i shpejtë i teknologjisë ka sjellë një kategori të re biznesesh, kompanitë e teknologjisë në sigurime, të cilat në disa fusha po përfitojnë nga evoluimi i ngadaltë i rregulloreve.

Sigurimi motorik, i cili mesatarisht zë 35% të primeve të shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës, mbetet një nga linjat kryesore të biznesit të siguruesve. Në shumë tregje, reputacioni i industrisë së sigurimeve varet nga “përshtypjet e para” të grupit më të madh të konsumatorëve, drejtuesit e makinave.

## Banka e Anglisë, marrëveshje me ESMA-n

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Banka e Anglisë dhe Autoriteti Evropian i Titujve dhe i Tregjeve (ESMA) kanë rënë dakord për një memorandum bashkëpunimi për shkëmbim informacioni për kundërpakitë qendrore të klerimit dhe depozitarët qendrorë. Memorandumi i bashkëpunimit vjen pas miratimit nga Komisioni Evropian në muajin dhjetor 2018 të vendimeve të përkohshme për kuadrin ligjor dhe mbikëqyrës të kundërpakitë qendrore të klerimit dhe depozitarëve britanikë.

Këto masa do të hyjnë në fuqi në rastin e largimit të Britanisë nga BE pa marrëveshje. Nëse ndodh një gjë e tillë, kundërpakitë qendrore të klerimit dhe depozitarët qendrorë britanikë do të njiheshin nga ESMA, duke nisur nga data 30 mars 2019. Kjo do t'u jepte mundësi atyre që të vijonin me ofrimin e shërbimeve për anëtarët e klerimit në BE.





---

---

## AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Për informacion të mëtejshëm  
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë  
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686  
[amf@amf.gov.al](mailto:amf@amf.gov.al) | [www.amf.gov.al](http://www.amf.gov.al)